



## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMUNA E KAMENICËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	KM653-20-3238-5-2-1
Nr i brendshëm	KM653-20-010-521

Sa i përket tenderit për :Zhvillimi socio ekonomik në Komunën e Kamenicës përmes ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza në fshatin Koretin

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

K.N.T.SH."TEUTA-M" sh.p.k

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Skifter Arifi nr.67, lagja Arberira

(Adresa)

Gjilan

60000

(Vendi)

(Kodi postar)

044 / 770-962

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Petrit Jerliu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ps.teutam@gmail.com

(Adresa elektronike)

06.11.2020

(Data e parashtrimi të ankesës)

(Nënshkrimi dhe data)

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].*

Njoftimi për Kontratë: 26.06.2020  
Data e parashikuar e hapjes së ofertave: 21.07.2020  
Kërkesa për rishqyrtim: 26.10.2020  
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 28.10.2020

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

☐

Jo

☒

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

☒

Jo

☐

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

☒

Jo

☐

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 58 i LPP-së  
Neni 59 i LPP-së  
Neni 60 i LPP-së  
Neni 72 i LPP-së  
Neni 39.8 i RRUOPP-së.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Ju sqarojmë se në vlerësimin e parë ne kemi qenë të rekomanduar për kontratë, ndërsa ankues ka qenë kompania "El-bau&Sinani" Ing sh.p.k, ndërsa pas vendimit të OSHP-së nr.617/20 të





dt.13.10.2020, autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë OE "El-bau&Sinani" Ing sh.p.k, ndërsa neve na ka eliminuar si ofertues të papërgjegjshëm.

Fillimisht ju sqarojmë se OE "El-bau&Sinani" Ing sh.p.k është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar formularin e tenderit siç duhet dhe njëkohësisht ka ofertuar me dy çmime të ndryshme, në paramasë ka çmimin prej:124,305.33 €, kurse tek formulari i tenderit ka ofruar çmim prej: 121,355.33 €, e që dallimi ndërmjet këtyre dy çmimeve është 2.37%.

Duke pasur parasysh këtë fakt OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk lejohet të ofertohej me dy çmime dhe rezultojnë se formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet, prandaj sipas nenit 39.8 të RRUOPP:

**Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon /Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm"**

Pra në këtë rast është dashur të zbatohet ky sqarim i RRUOPP dhe është dashur të eliminohet OE i rekomanduar për kontratë e jo të shpërblehet me kontratë dhe të favorizohet.

Gjithashtu me këtë fakt kuptohet që OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me variante me dy çmime, ndërsa në dosje të tenderit nuk janë autorizuar variantet, prandaj ofertimi i OE të rekomanduar për kontratë me dy çmime përveç se kuptohet si mosplotësim si duhet i formularit të tenderit rezultojnë të jetë edhe ofertim me variante në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

Sa për informim sipas nenit 18.3 pjesa c të RRUOPP, **Formulari për dorëzimin e ofertës**, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Ajo përbëhet nga:

- Formulari i tenderit
- Lista e çmimeve

Pra duke u bazuar në këtë dispozitë kuptohet që plotësimi i formularit të tenderit duhet të bëhet është siç kërkohet sepse formulari i tenderit është pjesa kryesore e tenderit.

Duke u bazuar në këtë sqarim rezultojnë se formulari për dorëzimin e ofertës nuk është plotësuar siç duhet sepse tek formulari i tenderit është dhënë një çmim tjetër, kurse tek lista e çmimeve është dhënë një çmim tjetër, prandaj kjo diskrepancë në çmime nuk mund të interpretohet ndryshe përveç se mos plotësim siç duhet i formularit për dorëzim të ofertës, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohet nga konkurrenca si OE i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në dispozitën e lartpërmendur të RRUOPP-së, atëherë shtrohet pyetja se me cilin çmim duhet të nënshkruhet kontrata eventuale ose cili çmim duhet të merret parasysh si çmim ofertues, pasi që në këtë dispozitë dhe në asnjë dispozitë të LPP-së askund nuk thuhet dhe parashihet që çmimi tek paramasa është mbizotërues. OSHP-ja në vendimin nr.617/20 të dt.13.10.2020 duke u bazuar në mendimin e ekspertit shqyrtues ka konstatuar se çmimi i tabelës së paramasës së ofertës është mbizotërues. Kur merret një vendim dhe kur konstatohet një gjë e tillë duhet referuar dhe bazuar në ndonjë dispozitë ligjore e jo të konstatohet me mendime subjektive të ekspertit, i cili në asnjë mënyrë nuk e ka sqaruar se ku shkruan që çmimi i tabelës së paramasës së ofertës është mbizotërues, prandaj ky konstatim i panelit shqyrtues duke u bazuar në konstatimet e ekspertit shqyrtues duhet korrigjuar sepse nuk ka asnjë mbështetje ligjore.

Paneli shqyrtues po ashtu është bazuar në ekspertizën e ekspertit shqyrtues i cili në ekspertizë ka theksuar se OE kanë përdor tabelën e çmimeve në formatin Excel dhe nuk është përdor forma standarde e sistemit të e-prokurimit që do ta gjeneronte çmimin në mënyrë automatike në formularin e tenderit, e që për ekspertin ky është një gabim teknik dhe është dashur të kërkohen sqarime sipas nenit 59.2 të LPP-së.

Lidhur me këtë konstatim ju sqarojmë se operatorët ekonomik kanë të drejtë të përdorin edhe formën standarde e edhe formën jo standarde të çmimeve, prandaj cilëndo formë që e përdorin nuk mund të arsyetohen operatorët ekonomik nga eksperti shqyrtues se kanë bërë gabim. Përderisa lejohet të përdoren të dy format standarde të çmimeve atëherë është e drejtë e tyre ti përdorin cilën do, mirëpo në raste kur përdoret edhe forma jo standarde është përgjegjësi e OE të ofertojnë siç duhet dhe të plotësohet formulari i tenderit në harmoni me ligjin e prokurimit publik.



Në këtë rast ekspertit shqyrtues ka luajtur rolin e avokatit të OE "El-Bau" & "Sinani Ing" sh.p.k, duke e arsyetuar se ka bërë gabim teknik, prandaj shtrohet pyetja se si e ka kuptuar ekspertit shqyrtues se i njëjti OE ka bërë gabim teknik, dhe shtrohet pyetja se çfarë sqarime mund të kërkohej në këtë rast, ku përgjigjet operatori ekonomik i jep në atë mënyrë se cila formë i shkon përshtati. Edhe neni 18.3 i RRUOPP e parashih qartë që "OE nuk duhet të nënshkruajnë manualisht formularin e tenderit ( i cili gjenerohet nga sistemi) dhe listën e çmimeve, pavarësisht se a është përdorë Lista e çmimeve standarde ose jo-standarde". Pra kjo dispozitë e qartëson se OE mund të përdorin cilën do formë standarde apo jo standarde të çmimeve.

Duke pasur parasysh të gjitha këto fakte dhe sqarime që ne i elaboruam më lartë, operatori ekonomik "El-Bau" & "Sinani Ing sh.p.k është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

Këto raste edhe vetë OSHP-ja në të kaluarën i ka trajtuar në mënyrë të njëjtë duke i shpallur të papërgjegjshëm operatorët ekonomik të cilët kanë ofertuar me dy çmime. Kësi raste ka disa që janë marrë vendime nga OSHP, kurse ne po ja u sjellëm vetëm dy:

*Si rast praktik i OSHP-së në marrjen e vendimeve po ju citojmë dhe sqarojmë vendimin nr.635/19 i datës:11.11.2019*

- Vendimi nr.635/19 i datës:11.11.2019 qartë e ka konstatuar se OE Laguna Shpk si OE ankues, ka ofertuar me dy çmime të ndryshme, prandaj për këtë arsye me këtë vendim edhe paneli shqyrtues e edhe Ekspertja Shqyrtuese e kanë **VËRTETUAR** një vendim të AK-së i cili e ka eliminuar një OE për procedurën e tenderit nr:624-19-5768-2-2-1 ku rasti ka qenë i njëjtë pasi OE ankues ka aplikuar në atë procedurë të tenderit me dy çmime të ndryshme.
- Në ekspertizën në fjalë ekspertja shqyrtuese thotë, citojmë":
- *Ekspertit shqyrtues, me rastin e kontrollimit të dokumentacionin të dorëzuar për këtë tender, konstaton se AK, me të drejtë e ka eliminuar tenderuesin ankues: Laguna Shpk sepse me rastin e dorëzimit të tenderit, Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet, janë dorëzuar dy çmime të ndryshme.*
- *Në formularin për dorëzim të tenderit ka vendosur një çmim, ndërsa tek pjesa II. Përshkrimi i çmimeve totali i çmimit është tjetër.*
- *Megjithatë Formulari I tenderit nga tenderuesi ankues nuk është plotësuar si duhet, bazuar në Rregullat dhe Udhëzimet Operativ për Prokurim Publik si të veprohet në raste të tilla, Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon. Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.*

Kurse Paneli Shqyrtues për rastin e njëjtë të lëndës së njëjtë e konfirmon mendimin e ekspertit shqyrtues ku për më tepër citoj sipas vendimit të OSHP-ës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se AK, me të drejtë e ka eliminuar OE ankues nr.635/19 i datës:11.11.2019, sepse me rastin e dorëzimit të tenderit, Formulari I tenderi i OE në fjalë nuk është plotësuar si duhet, janë dorëzuar dy çmime të ndryshme:

Në formularin për dorëzimin e tenderit ka vendosur çmim tjetër, kurse tek përshkrimi i çmimeve totali është çmim tjetër.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se Formulari i tenderit i dorëzuar nga tenderuesi ankues nuk është plotësuar si duhet, konstatojmë se AK ka vepruar në pajtim me nenin 39.8 RRUOPP kur ka refuzuar tenderin e OE ankues sepse neni 39.8 të Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik thuhet: Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon. Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.



Shih vendimin e bashkangjitur në këtë ankesë.

*Gjithashtu po ju citojmë edhe një vendim tjetër të OSHP, kur me këtë vendim e ka anuluar dhenjen e kontrates te AK.*

- **Vendimi i OSHP nr.695/18 i datës: 08.01.2019** ku me këtë vendim OSHP ka **HEDHUR POSHTË** dhënjen e një kontrate te AK me nr.prokurimit 701-18-7023-211 dhe lëndën e ka kthyer në Ri-vlerësim. Gjegjësisht edhe Eksperti shqyrtues dhe Paneli shqyrtues e kanë pasur mendimin dhe vendimin e njëjtë mbi lëndën në fjalë ku OE ka dorzuar dy cmime; një cmim tjetër në formularin e tenderit dhe një cmim tjetër tek totali i ofertës.
- Bazuar në vendimin e ekspertit shqyrtues dhe aprovimin të panelit shqyrtues të OSHP për lëndën në fjalë thuhet, citoj sipas vendimit të OSHP:

*Bazuar në nenin 59 pika 3 e të LPP-së, nuk mundet të përmisohen gabimet në totalin e ofertës më shumë se 2% të vlerës së sajë. Në këtë rastë e ka tejkaluar shumë herë këtë vlerë.*

*Prandaj Ekspertit shqyrtues e vlerëson këtë pretendim ankimor të bazuar.*

*Kurse për pikën e njëjtë paneli shqyrtues për lëndën e njëjtë thotë, gjithëmon citoj sipas vendimit të vetë të OSHP-ës:*

*Gjatë shqyrtimit të kësaj lënde vërehet qartë se AK ka bërë lëshime dhe dobësi gjatë procesit të ekzaminimit, i vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve sepse ka shpërblyer me kontratë OE i cili ka pasur gabime esencilae gjatë plotësimit të ofertës respektivisht listës së cmimeve.*

**FORMULARI I TENDERIT NUK ËSHTË PLOTËSUE SI DUHET.**

*Pra OE fitues nuk e ka plotësuar listën e cmimeve dhe dokumentacionin e tenderit si duhet.*

*Prandaj bë bazë të nenit 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Administrativ të Prokurimit, kur Formulari I tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon, duhet të regullohet tenderi.*

*Paneli shqyrtues sqaron se bazuar në nenin 59 pika 3 të LPP-së nuk mundet të përmisohen*

**GABIMET NË TOTALIN E OFERTËS më shumë se 2% të vlerës së sajë.**

Shih vendimin e bashkangjitur në këtë ankesë.

Duke u bazuar në rastet që e përmendëm më lartë (të tilla raste ka edhe më shumë), ju si OSHP duhet të veproni në mënyrë të njëjtë për raste të njëjta e jo të përdorni standarde të dyfishta në raste të caktuara.

Autoriteti kontraktues me të drejtë e kishte eliminuar herën e parë OE El-bau&Sinani sh.p.k sipas neni 39.8 ku thuhet që të eliminohet tenderi pa kërkuar sqarime shtesë në raste kur nuk është plotësuar siç duhet formulari i tenderit.

Ne mendojmë që këtu është bërë lëshimi nga OSHP kur pikën e njëjtë e ka shqyrtuar gabim teknik, kurse nuk është vepruar sipas vendimeve të më hershme.

*OE në fjalë duhet të eliminohet menjëherë duke mos kërkuar sqarime shtesë, sepse OE në fjalë po ashtu ka gabim tek totali i ofertës mbi 2% ndërmjet çmimit të ofruar në Formular të tenderit dhe në paramasë: tek formulari ka dorëzuar çmimin 121,355.33 €, kurse tek totali i ofertës tek përshkrimi i çmimeve është 124,305.33 €, e që i bie të jetë dallimi +2.37%, dhe sipas vendimeve të më hershme dhe ligjeve të KRPP-ës OE i rekomanduar për kontratë në ri-vlerësim nuk e plotëson kushtin bazik në nenin 59 pika 3 ku qartë thuhet që gabimet në totalin e ofertës nuk mund të kalojnë më shumë se 2% e vlerës së sajë, si dhe nuk e ka plotësuar kushtin bazik sipas neni 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, ku OE në fjalë është dashur të eliminohet direkt pasi nuk e ka mbushur Formularin e tenderit siç duhet.*

Për ne si kompani është çudi e madhe se si OSHP gabimin e tillë për këtë procedurë e ka konsideruar si gabim teknik i vogël, kurse për gjitha procedura tjera ka vepruar sipas ligjeve në fuqi.



Sa i përket vendimit të OSHP rreth Certifikatës së Armiruesit për Sokol Jerliu të lëshuar nga Qendra e Aftësimit Profesional, është çudi se si ju si AK keni pasur një procedurë tjetër (tani më kontratë të lidhur) të tenderit ku e njëjta lëndë ka shkuar në OSHP, përveç shumë pikave të shtjelluara në procedurën e tenderit: Ndërtimi i Bulevardit të Qytetit në Kamenicë me nr.653-19-7082-5-1-1 dhe me vendim të OSHP nr.901/19 të datës:20.01.2020 ku grupi i OE ekonomik përveç tjerave është ankuar edhe në pikën ku në këtë tender OE i shpërblyer me kontratë ka certifikata nga e njëjta qendër e aftësimit profesional me emrin "Arsimimi" me nr.biznesi 70217821. Dhe ju si AK në vendimin tuaj asnjëherë nuk e keni cekur që një rast rreth kësaj Qendre vetëm është trajtuar dhe ka vendim të OSHP-ës.

Sipas vendimit të OSHP gjithmonë duke e cituar:

Paneli Shqyrtues në vendimin e lartpërmendur ka konstatuar si në vijim:

**Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sa i përket dëshmive të prezantuara nga OE i shpallur fitues përkatësisht Certifikatës të lëshuar nga qendra për aftësim profesional, paneli shqyrtues bazuar në shkresat e lëndës dhe faktet e gjetura vjen në përfundim se pretendimi i OE ankues është i pabazuar. OE i rekomanduar për kontratë lidhur me plotësimin e kërkesës në fjalë ka dorëzuar dëshmitë dokumentare-certifikatat e lësuara nga qendra e aftësimit profesional të cila përmbajnë nr. Regjistrimit, nr. e protokollit dhe nënshkrimin e qendrës profesionale. Sa i përket dilemave të shfaqura lidhur me vërtetësinë e tyre, paneli shqyrtues konstaton se verifikimi dhe prejardhja e tyre nuk është në kompetencën e OSHP-ës", mbarim citati.**

**Shih vendimin e bashkangjitur në këtë ankesë.**

Kurse në këtë procedurë të tenderit në rastin tonë OSHP ka cekur që trajnimi është bërë para regjistrimit të Qendrës për Aftësim Profesional me nr. Biznesi 70217821 (është fjala për qendrën e njëjtë sikur tek procedura e tenderit për Ndërtimin e Bulevardit të Qytetit me nr.653-19-7082-5-1-1) d.m.th. para datës 30.12.2004 edhe pse data e lëshimit të diplomës në certifikatë është 24.01.2005 që i bie DATA E DIPLOMËS ËSHTË MBASI QË ËSHTË REGJISTRU KJO QENDËR më 30.12.2004.

OSHP dhe AK-ja e din shumë mirë se trajnimi dhe certifikimi apo diplomimi janë dy gjëra të ndryshme. Personi në fjalë është diplomuar pasi që Qendra në fjalë është regjistruar.

Gjithashtu në kërkesën e dosjes së tenderit për këtë procedurë është kërkuar:

**1(një) Mjeshtër I armaturës me diplome nga qendra e aftësimit profesional me përvojë min.5 vite pas diplomimit.**

Siç shihet mirë nuk janë kërkuar data e trajnimit, apo vetëm dëshmi e trajnimit, mirëpo qartë dhe saktë Diplomë nga qendra e aftësimit profesional. Gjithashtu nuk është kërkuar Diplomë nga Institucionet Shtetërore, mirëpo Diplome nga qendra e aftësimit profesional.

Duke e pasur parasysh që AK dhe OSHP kanë pasur një lëndë dhe një vendim për një diplomë të tillë nga e njëjta qendër e cila diplomë në rastin e tenderit për Ndërtimin e Bulevardit të Qytetit me nr.653-19-7082-5-1-1 ka qenë e lëshuar edhe para datës së regjistrimit të qendrës (e cila është lëshuar për afërsisht rreth 1 viti më herët se të regjistrohet qendra në ARBK) ku OSHP ka marr vendim që është në rregull, kurse diploma jonë është e lëshuar pasi është regjistruar qendra. Kërkojmë nga OSHP që ti shoshit gjitha dëshmitë dhe faktet pasi na është bërë padrejtësi e madhe, dhe AK në rivlerësim ta marr vendimin e duhur.

Ne mendojmë që OSHP-së nuk ju është ofruar dëshmi dhe fakte të mjaftueshme nga AK mbi pikën në fjalë edhe pse për gjitha pikat e njëjta ka marr vetë vendime më herët, dhe andaj ka marr vendim kontravers dhe në kundërshtim me vendimet e saja të mëhershme, duke e pasur parasysh gjithashtu





edhe numrin e madh të ankesave në shqyrtim si dhe kohën në pandemi me virus, ne nuk kemi shpjegim tjetër dhe nuk dëshirojmë të paragjykojmë vendimin e AK si dhe të OSHP-ës.

Ne pajtohemi me arsyet e AK-së për eliminimin e grupit të OE **KUSHTRIMI NM SH.P.K & Arhiko ING O.P.**, pasi që siç e ka cekur edhe AK-ja ky grup i OE është i papërgjegjshëm.

Ne me dt.28.10.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.

Në lidhje me arsyen e AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, ju sqarojmë se ky arsyetim është i pa bazuar pasi që AK-ja nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore, duke i vërtetuar edhe më shumë këto pretendime pasi që nëse pretendimet tona ankimore nuk do të ishin të qëndrueshme, atëherë AK-ja do të ofronte dëshmi se pretendimet tona nuk qëndrojnë.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se arsyetimi i AK-së është i pa bazuar dhe nuk qëndron.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet faktike dhe ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

#### **VENDIM**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE **"Teuta-M" shpk**

**ANULOHET**, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**,

**DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

